

INFORMACIONE



KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

PASQYRA E AKTIVITETEVE TE MUAJIT SHTATOR

1 Shtator	KOKSH & AEFSs (Bashkëpunimi)
3 Shtator	Skuadra Olimpikë Shqiptare (Pritje nga Presidenti i KOKSH)
7 Shtator	Komisioni Teknik (Mbledhje Post „Athina 2004“)
9 Shtator	Delegacioni Olimpik (Pritje e Sponsorit Zyrtar “AMC”)
9-10 Shtator	Këshilli i Europës (Konferenca ne Stamboll/Turqi)
10 Shtator	Komiteti Ekzekutiv (Mbledhje në KOKSH)
18 Shtator	Kuvendi Popullor (Mbledhje e Komisionit te Sportit)
20 Shtator	UNDP (Takim pune)
20-25 Shtator	KOKSH – Komiteti Olimpik Slloven (Eksperiencë Bashkëpunimi)
20 Shtator	KOMPAS II - Mbledhje e Tutorëve
25 Shtator	Festivali Vrapimit « Let’s Run Together » - Edicioni IV
27-29 Shtator	Kursi Rajonal i Administratorëve Sportivë -Vlorë

SHTATOR 2004

1 Shtator KOKSH & AEFS (Bashkëpunim dhe mbështetje me Baze Materiale)

Në kuadër të protokoll marrëveshjes së bashkëpunimit me Komitetin Olimpik Zviceran, e cila mundësoi dhurimin e një sasive të konsiderueshme kancelarike dhe logjistike të zyrave, KOKSH vazhdon mbështetjen dhe ndihmën e tij si në anë materiale ashtu dhe në atë teknike. Bazuar edhe në Protokoll marrëveshjen me Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve « Vojo Kushi », KOKSH i dhuron AEFSs 3 kompjutra IBM dhe materiale të ndryshme kancelarike. Ky dorëzim u realizua në mënyrë ceremoniale në AEFS nga Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH Stavri Bello, Rektorit të i AEFS « Vojo Kushi » z. Sejfulla Shtëpani.

3 Shtator Skuadra Olimpikë Shqiptare

pas kthimit në Shqipëri u prit zyrtarisht nga Presidenti i KOKSH Hysen Domi në prani të Sekretarit të Përgjithshëm Stavri Bello dhe Shefit të Misionit të Skuadrës Olimpikë « Athina 2004 » z. Fidel Ylli në ambjentet e KOKSH. Presidenti Domi duke vlerësuar seriozitetin e tyre në përfaqësimin e Kombit tonë në Olimpiadën « Athina 2004 » i falenderoi sportistët për përpjekjet e tyre duke ju thënë se « ...Ka ende për të bërë për rritjen e rezultateve në mënyrë që në Lojrat e ardhëshme Olimpikë « Pekin 2008 » Shqipëria të arrijë rezultate më të larta, madje të hyjë në zonë medaljesh... » Për këtë, KOKSH do të kujdeset që bashkërendimi i punëve me Feratat Sportive të jetë më i mirë dhe më cilësor.

7 Shtator Komisionit Teknik i KOKSH

i kryesuar nga Fidel Ylli, zhvilloi mbledhjen post-Olimpiadë për të analizuar *përfaqësimin e Shqipërisë në Lojrat Olimpikë "Athina 2004"*. Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e komisionit, të ftuar nga Federatat jo vetëm nga ato pjesëmarrëse në Olimpiadë, Sportistët dhe Trainerët e Skuadrës Olimpikë Shqiptare në "Athina 2004" dhe specialistë të sportit. Në këtë mbledhje asistoi Presidenti i KOKSH z. Hysen Domi dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Stavri Bello,

Drejtori i QKSH Bashkim Milo, si dhe Drejtuesi i Departamentit të Sportit në Bashkinë e Tiranës z. Rauf Dimraj.

9 Shtator "AMC" – Sponsor Zyrtar i KOKSH Pritje e Delegacionit Olimpik

Kompania "AMC" Sponsori Zyrtar i KOKSH dhe njëkohësisht sponsor i Delegacionit Olimpik, organizoi në abjentet e kompanisë pritjen zyrtare për nder të Delegacionit Olimpik Shqiptar që mori pjesë në Lojrat Olimpikë « Athina 2004 ». Delegacionin Olimpik të kryesuar nga Presidenti i KOKSH z. Domi, e priti Drejtuesi i Përgjithshëm i AMC z. Oktapodas. « Athina 2004 » ishte vetëm fillimi i një bashkëpunimi afatgjatë dy palësh, dhe AMC është e kënaqur të vazhdojë mbështetjen e saj – Tha Drejtuesi i Përgjithshëm i AMC, Stefanos Octapodas.

9-10 Shtator Këshilli i Europës/ Konferencë

Këshilli i Europës organizoi në Stamboll të Turqisë në datat 9-10 Shtator Konferencën me temë « Kontributi i Sportit në Dialogun Ndërkultural ». Në konferencë u mbajtën tema sesi sporti shërben në njohjen, bashkëpunimin dhe dialogun midis kulturave të ndryshme, sesi ai përshtatet dhe gjen gjuhën e përbashkët për një jetë miqësore dhe paqësore midis njerëzve, racave dhe kulturave të popujve të ndryshëm të Europës e më gjerë. Në këtë konferencë u përfaqësua edhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.

10 Shtator Komiteti Ekzekutiv i KOKSH,

zhvilloi mbledhjen e radhes, nën drejtimin e Presidentit Hysen Domi, me objekt kryesor përfaqësimin e Shqipërisë në Lojrat Olimpikë « Athina 2004 ». Në këtë mbledhje u morën në konsideratë vlerësimet dhe konkluzionet e Komisionit Teknik në mbledhjen e tij për pjesëmarrjen e Ekipit Shqiptar në Lojrat Olimpikë « Athina 2004 ».

18 Shtator

Kuvendi Popullor seancë për L.O. dhe Sportin

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello ka përfaqësuar KOKSH në seancën e mbledhjes së Komisionit të Shkencës, Arsimit, Kulturës dhe Sportit të Kuvendit Popullor. Objekti i kësaj mbledhje ishte përfaqësimi i Shqipërisë në Lojrat Olimpikë « Athina 2004 », Konkluzionet dhe rekomandimet për përgatitjen e ardhëshme drejt “Pekin 2008”.

20 Shtator Objektivat e Mijëvjeçarit / UNDP

KOKSH, në kuadër të vazhdimësisë së bashkëpunimit me UNDP në lidhje me projektin « *Zhvillimi i të Rinjëve nëpërmjet Sportit* », u zhvillua një takim pune me të gjithë partnerët e këtij projekti për inspektimin e situatës dhe vazhdimin e më tejshëm të projektit.

20-25 Shtator KOKSH & K. Olimpik Slloven

Në kuadër të bashkëpunimit midis Komiteteve Olimpikë Europiane, bazuar kjo në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të KOE në Beograd për shkëmbim eksperiencash dhe njohurish në lidhje me Menaxhimin midis NOC-ve, znj. Violeta Shqevi përfaqësuese e KOKSH organizoi një stazh pune një javore për të parë dhe njohur më nga afër eksperiencën e Komitetit Olimpik Slloven në aspektin e drejtimit dhe menaxhimit në përgjithësi.

20 Shtator KOMPAS II - Mbledhje e tutorëve

Në ambjentet AEFS « Vojo Kushi » u zhvillua mbledhja e Tutorëve të KOMPAS II. Në

mbledhje u diskutua mbi masat organizative të seminarit të fundit i cili është njëkohësisht edhe seminari i mbrojtjes së temave të Studentëve.

25 Shtator

Samsung & KOKSH Konferencë Shtypi

Në kuadër të Festivalit të Vrapimit « *Let's Run Together* » - Edicioni IV, pas koordinimit të punëve për organizimin e Festivalit të vrapimit « Let's Run Together » dy ditë para fillimit të tij në dt. 23 Komiteti Organizator dha një konferencë shtypi për këtë evenimentet.

Organizohet Festivali i Vrapimit

Nëpërmjet bashkëpunimit të Kompanisë Samsung, Komitetit Olimpik Kombëtar SHhqiptar dhe Bashkisë Tiranë u bë i mundur organizimi i aktivitetit masiv të vrapimit « Le të Vrapojmë Sëbashku ». Në këtë edicion të katërt të tij, ndonëse në një ditë me shi, kjo festë pati suksesin e saj, si dhe u shpërndanë dhurata speciale nga Kompania Samsung për fituesit e llotarisë, gjithashtu u dhuruan pajisje të kompanisë për institucione publike në shërbim të komunitetit.

27-29 Shtator Kursi Rajonal për Administratorët Sportivë-Vlorë

KOKSH organizoi kursin tre ditor për Administratorët Sportivë, në prefekturën e Vlorës. Për KOKSH ky është Kursi i 6të zhvilluar në rang prefekturë në Shqipëri, dhe gjithashtu këtu ka patur 21 pjesmarrës nga institucione të ndryshme sportive, kryesisht nga qyteti i Vlorës dhe Fierit. Drejtues klubesh, inspektorë të sportit në prefekturë, bashki dhe drejtorë arsimore, gjithashtu trainerë dhe mësues të edukimit fizik, përbënin auditorin e këtij Kursi.
